



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 356 Prot.

Tiranë, më 13.032019

VENDIM Nr. 40 datë 06.03.2019

Në mbështetje të *Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë"*, Neni 48, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 2, datë 06.03.2019, pasi shqyrtoi kërkesën për miratim të projektit *"Rikonstruksioni objektit ekzistues 1 kat dhe shtesë 3 kate", rruga "Mujo Ulqinaku", zonë arkeologjike "B" Durrës* -subjekti "ALBET"sh.p.k., raportin mbi pritshmërinë arkeologjike të zonës dhe konceptin e sondazhit arkeologjik, paraqitur nga individ i licencuar në arkeologji Z. Eduard Shehi.

VENDOSI:

1. Të miratojë konceptin e sondazhit arkeologjik në kuadër të projektit *"Rikonstruksioni objektit ekzistues 1 kat dhe shtesë 3 kate", rruga "Mujo Ulqinaku", zonë arkeologjike "B" Durrës*-subjekti "ALBET"sh.p.k., paraqitur nga subjekt i licencuar në arkeologji Z. Eduard Shehi.
2. Subjekti "ALBET" sh.p.k. duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje tre palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili do të realizojë sondazhin arkeologjik, si dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, e cila do të mbikëqyrë këtë subjekt. Raporti i tij do të paraqitet në KKA e radhës.
3. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr.384, datë 21.10.2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.
4. Investitori "ALBET"sh.p.k. si dhe subjekti i licencuar në arkeologji, i cili do të kryejë sondazhin arkeologjik, në mbështetje të Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë", Rregullores "Mbi kriteret e ushtrimit të profesionit të arkeologut" (i ndryshuar) dhe akt-marrëveshjes tre palëshe të sipërcituar, janë të detyruar të marrin të gjitha masat për sigurimin dhe ruajtjen e kantierit, si dhe ruajtjen e strukturave arkeologjike, të cilat mund të zbulohen gjatë kryerjes së sondazhit, deri në vendimmarrjen përfundimtare të KKA, në lidhje me të.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

**KRYETAR
ELVA MARGARITI
MINISTËR**



**SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO**